



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.314/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjor Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, kundër Inciativë së Re Demokratike të Kosovës (IRDK), me seli në Gjakovë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Anr.314/2019 e datës 06.10.2019, me të cilin ka kërkuar që subjekti politik Inciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), t'i shqiptohet dënim me gjobë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore - thirrjes për votim në rrjetin social Facebook.

A r s y e t i m

Paraqitësi i ankesës Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me datën 06.10.2019, ka paraqit ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, subjekti politik Inciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), ka bërë thirrje që të votohet subjekti politik në fjalë përmes një postimit të bërë në llogarinë e simpatizantit në rrjetin social facebook, të subjektit politik IRDK, Rexhep Hasani. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet e bazuar.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik IRDK, theksohet se ankesa është e pabazë ngase personi i identifikuar nga ankuesi, Rexhep Hasani, nuk është pjesë e subjektit politik IRDK, dhe se nuk ka mundësi dhe as kompetencë ta vërtetojë saktësinë e publikimeve në llogarinë e personit në fjalë në rrjeti social facebook. Me propozim për PZAP-in, që ankesa e parashtruar nga PLE të hedhet e pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografive të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, ka vlerësuar se ankesa A.nr.314/2019, e dt. 06.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik PLE, ndaj subjektit politik IRDK, nga shkresat e lëndës shihet se nga postimi i bërë në llogarinë e rrjetit social facebook, të simpatizantit “organizatorit për tubime elektorale”, nga radhët e partisë IRDK, Rexhep Hasani, përmes të cilës ka bërë thirrje për votim subjektin politik IRDK me nr.131, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, vlerëson se në bazë të provave të ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se postimi është bërë në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e postimit të bërë të shkelësit të supozuar siç pretendohet në ankesa, siç përcaktohet me nenin 117 paragraf 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, përmes thyerjes së heshtjes zgjedhore me datë: 05.10.2019, përmes të bërit fushatë në çfarëdo mënyre.

Ditën e shqyrtimit të këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por që nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse të njëjtat një ditë më parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimit të njëjtat kane qene jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e konform nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.314/2019 më datën 07.10.2019

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*

Kryesuesi i Panelit
Rrustem Thaqi

